



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 167 Prot.

Tiranë, më datë 28.02.2025

VENDIM

Nr. 150, datë 28.02.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.02.2025:

VENDOSI

1. Miratimin në parim të rishikimit të projektit “Ndërhyrje restauruese në fasadën e objektit ish-*“Hotel Internacional”*, Bashkia Tiranë, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, lidhur me kriteret për ndërhyrje në pasuri kulturore, me aplikues Znj. Xhej Baruti dhe zhvillues **Z. Eduard Kelmendi, me rekomandimin;**
 - Vendorsja e portës metalike që kufizon pjesën e pasme të objektit pasuri kulturore, të konkretizohet pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe konfliktit me palën kufitare;
 2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
 3. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Joli MITROJORGJI

